



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Data __.__.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE MATERIALE PASTRIMI PËR NEVOJA TË BASHKISË SHIJAK ”,

TIPI I KONTRATËS- MALL

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Produkte pastrami

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.000.000 (dy milion) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, njësia e prokurimit në Bashknë Shijak ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertes ekonomike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të paktën 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-se, për të cilin duhet të paraqitet vërtetimi i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nënën 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2022 – 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nënën 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Përvoja e ngjashme :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontrata të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet të jete të minimalisht deri në 20% e vlerës të kontratës që po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara. (Per kontratat në sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3 Aftesite teknike dhe profesionale

2.3.1 Materialet e Pastrimit të jenë cilësore sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të mallrave, Afati i skadences: (per mallrat të cilat kanë skadence) data e skadences në ditën e levrimit të mallit duhet të jete jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadences.

Ky kriter është kriter që rrit sigurinë tek Autoriteti Kontraktor që mallrat janë cilësor dhe kanë afat përdorimi

Operatori ekonomik të vertetojë (me deklarate) që artikujt (solucionet) objekt prokurimi, të kenë afat përdorimi të paktën 1 vit nga moment i lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar dhe do të ofrojë produktet e kërkuara me cilësi, pasi këto produkte do

te perdoren per nevojat e institucionit , azilit, konviktit dhe shkollave brenda vitit dhe prandaj eshte e domosdoshme qe produktet te jene cilesore dhe konkretisht me afat perdorimi 1 vit.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikate të menaxhimit të cilësisë ISO **ISO 9001:2015** – Certifikim për Menaxhimin e Cilësisë, ose ekuivalente (e vlefshme); për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit në mënyre qe OE te siguroje një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane e cila duhet te jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standardi tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO; **(Këto dokumente duhet te jene te përkthyer dhe noterizuar);**

a. ISO 14001:2015 – Certifikim për Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalente (e vlefshme); për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit në mënyre qe OE te siguroje një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane e cila duhet te jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standardi tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO; **(Këto dokumente duhet te jene te përkthyer dhe noterizuar);**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit te menaxhimit te cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoriteteve ne lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit te biznesit ne tërësi.

ISO 9001 përfaqëson Standardin Ndërkombëtar unanim i njohur si standardi që i përket kërkesave për një Sistem Menaxhimi të Cilësisë. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës se aktivitetit.

ISO 14001 përfaqëson standardin ndërkombëtar unanim i njohur si standardi qe i përket kërkesave për një sistem të menaxhimit mjedisor. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës se aktivitetit.

Gjithashtu, këto certifikata janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë, duke garantuar në këtë mënyrë se furnizimi i mallrave do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit sipas kontratave të ngjashme në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Shenim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “ Cilesia e pare”, ky përcaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike